



Funded by
the European Union



FARM to FORK
ACADEMY

AKADEMIA “NGA FERMA NË TRYEZË” PËR BALLKANIN PERËNDIMOR TË GJELBËR – E ARDHMJA JONË E PËRBASHKËT EVROPIANE

Projekti rajonal "Akademia nga Ferma në Tryezë për Ballkanin Perëndimor të Gjelbër - E ardhmja jonë e përbashkët evropiane" përfshin shtetet: Shqipëria, Bosnje dhe Hercegovinën, Kosovë*, Mal i Zi, Maqedoni e Veriut, Serbi dhe Kroaci. Projekti “Akademia nga Ferma në Tryezë” - zbatohet bashkërisht nga familja e Rrjeteve Kombëtare të Zhvillimit Rural (NRDNs) në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor (BP-6), në Kroaci dhe nga platforma e tyre rajonale e bashkëpunimit, Rrjeti Ballkanik për Zhvillim Rural (BRDN).

Titulli i projektit	Akademia nga Ferma në Tryezë për Ballkanin Perëndimor të Gjelbër - E ardhmja jonë e përbashkët evropiane
Financiar nga	Komisioni Evropian Mbështetje për rrjetet tematike rajonale të Organizatave të Shoqërisë Civile EuropeAid/174154/DH/ACT/Multi Lot 3: Tranzicioni i Gjelbër dhe Dixhital
Zona e zbatimit	Gjashtë vende e Ballkanit Perëndimor (BP-6) dhe Kroacia
Drejton projektin	Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural
Kohëzgjatja	16.01.2023 – 15.01.2027
Buxheti	1,442,183.16 Euro

*Ky emërtim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/1999 dhe Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës

Sfondi

Zonat rurale në gjashtë vende e Ballkanit Perëndimor (BP) janë shumë të rëndësishme si nga ana ekonomike dhe demografike. Bujqësia dhe zhvillimi rural është aktiviteti kryesor ekonomik, dhe luan rol thelbësor në zhvillimin social dhe ekonomik të rajonit. Megjithatë ky zhvillim rajonal pengohet nga sfidat, kufizimet në strukturë dhe në burime, që ekzistojnë në rajon. Humbjet në biodiversitet, ndryshimet klimatike dhe ekstremet e motit që prekin pronarët e vegjël në të gjithë rajonin, dhe fragmentizimi i madh i tokës bujqësore, ndikojnë në mënyrë negative në rajon dhe në qëndrueshmërinë e sektorit bujqësor. Gjashtë vendet e BP përballen me sfida të ngjashme në transformimin dhe modernizimin e sektorit të tyre të bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Ekziston një ndërgjegjësim i përgjithshëm për kompleksitetin dhe sfidat që paraqet procesi i reformës së sektorit agrar dhe rural drejt integritimit në BE për ekonomitë e vogla bujqësore. Fermerët e vegjël përballen me një sërë sfidash në sigurimin e standardeve të cilësisë së ushqimit dhe kërkesave të sigurisë ushqimore, në mënyrë që produktet e tyre të jenë konkurrues në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar. Si vijim, ende, nuk ka progres të mjaftueshëm për tranzicionin e gjelbër të sektorit. Nga ana tjetër, fermerëve u mungojnë njohuritë dhe aftësitë për të mbështetur praktikatat e qëndrueshme bujqësore, përfshirë dhe bujqësinë





Funded by
the European Union



FARM to FORK
ACADEMY

organike, ose nuk kanë arritur të përkrahin përdorimin e teknikave të reja ose të investojnë në makineri ose procese inteligjente me kosto efektive.

Gjashtë vendet e BP janë në proces të përafrimit të tyre ligjor me Politikën e Përbashkëta Bujqësore (CAP) të Bashkimit Evropian (BE) dhe si hap pasues për vendet e BP janë përpjekjet për t'u përafruar me masat e Agjendës së Gjellbër. Procesi udhëhiqet nga qeveritë e vendeve të Ballkanit Perëndimor, por NRDN-të janë aktorë të rëndësishëm të shoqërisë civile për të ndikuar në një proces të qëndrueshëm të integritimit evropian. NRDN-të duhet të përfshihen në të gjitha nivelet: që në përgatitjen, më tej në zbatimin dhe monitorimin e zbatimit të *acquis* të BE-së. Përveç ekspertizës dhe njohurive NRDN-të monitorojnë dhe ndikojnë në patjetën e qeverive të përgjegjshme, për të nxitur reforma të përsheptuara dhe për të zbatuar politikën e CAP të BE-së. NRDN-të synojnë me punën e tyre të forcojnë besimin në reformat dhe të gjenerojnë mbështetjen e nevojshme publike në procesin e integritimit në BE.

Ndërhyrja e Projektit

Projekti fokusohet në zbatimin e procesit të integritimit dhe përafrimit në BE për vendet e Ballkanit Perëndimor në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural duke avancuar tranzicionin e gjellbër dhe të drejtë në rajon përmes kontributit të aktorëve të shoqërisë civile. Projekti synon të stimulojë një mjedis më të mirë për Organizatën e Shoqërisë Civile (OSHC), rrjetet e OSHC-ve dhe palët e tjera të interesuara rurale, që përmes ngritjes së kapaciteteve të kontribuojnë në mënyrë proaktive në adresimin e sfidave shoqërore që lidhen me ndryshimet klimatike dhe humbjet e biodiversitetit. Kjo përjasja e projektit targeton zhvillimin e bujqësisë dhe të komuniteteve rurale drejt tranzicionit të gjellbër dhe të drejtë në të gjithë rajonin. Në të njëjtën kohë, projekti mbështet dhe nxit zhvillimin e konsultimeve pjesëmarrëse, nga poshtë lart dhe dialogun konstruktiv të politikave, për të përsheptuar procesin e reformimit në përafrimin me Politikën e Përbashkëta Bujqësore (CAP) të BE-së, në veçanti përafrimin me Marrëveshjen e Gjellbër të BE-së dhe me Strategjinë nga Ferma në Tryezë (F2F).

Kompetencat për ndikimin shoqëror

Akademia nga Ferma në Tryezë (F2F) do të mbështesë dhe ngrejë kapacitete të qëndrueshme të OSHC-ve dhe rrjeteve të OSHC-ve që të adresojnë në mënyrë efektive sfidat aktuale të shoqërisë. Kjo do të realizohet nëpërmjet ofrimit të programeve të trajnimit të krijuara për këtë akademi, që fokusohen në sistemet e qëndrueshme të ushqimit. Akademia nga Ferma në Tryezë synon të fuqizojë sektorin e shoqërisë civile, që të zhvillojë aktivitete për ti shërbyer më mirë sektorit të bujqësisë dhe komuniteteve rurale.

Akademia rajonale nga Ferma në Tryezë do të ofrojë një program trajnimi gjithëpërfshirës për Trajnim të Trajnerëve (ToT), që i drejtohet përfaqësuesve të OSHC-ve të gjashtë vendeve të BP. ToT-të do të mbulojnë tema specifike që lidhen me strategjinë F2F. Më pas, pjesëmarrësit e Trajnimit për Trajnerët do të transferojnë njohuritë e reja të fituara tek OSHC-të në nivel kombëtar brenda rajonit. Përpos trajnimit, do të zhvillohet nga NRDN-të një fushatë ndërgjegjësimi mbarëkombëtare mbi sistemin ushqimor të qëndrueshëm, të gjellbër dhe të ripërtëritshëm





Funded by
the European Union



FARM to FORK
ACADEMY

Zgjidhje të qëndrueshme lokale

Fondi i Akademisë F2F është ideuar për ti dhënë mbështetje financiare OSHC-ve dhe Rrjeteve të OSHC-ve, që zbatojnë aksione lokale promovuese të zgjidhjeve të reja, të gjelbra dhe gjithëpërfshirëse për sisteme të qëndrueshme ushqimore. Fondi i Akademisë F2F do të mbështesë NRDN-të në të gjashta vendet e BP dhe BRDN-në në përmirësimin e koalicionit dhe ndërtimin e kapaciteteve për të përforcuar ndikimin e OSHC-ve në bujqësi dhe në proceset e reformimit rural. **Çmimet e Akademisë F2F** do të shërbejnë si instrument për të prezantuar dhe promovuar zgjidhje të qëndrueshme në lidhje me mbrojtjen e mjedisit dhe biodiversitetit.

Për të nxitur rrjetëzimin, transferimin e njohurive, shkëmbimin e praktikave të mira në sistemet e qëndrueshme ushqimore, fondi i Akademisë F2F do të organizojë seminare të hapura demonstrimi të drejtuara për grupe të vogla fermerësh të rinj.

Advokimi nga poshtë lart dhe agjenda e politikave

Parimi themelor drejtues dhe perspektiva themeluese e NRDN-ve në 6 vendet e BP përqendrohet në promovimin nga poshtë-lart, të një procesi gjithëpërfshirës dhe pjesëmarrës të zhvillimit rural. Proceset e konsultimit me pjesëmarrje mbeten në qendër të nismave të ndërmarra nga NRND-të për të fuqizuar qasjen gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse ndaj zhvillimit lokal "nga poshtë lart". Në këtë këndvështrim, nismat e propozuara të advokimit në nivel rajonal dhe kombëtar synojnë të ngrenë zërin e popullatës rurale dhe grupeve të tjera vulnerabël si fermerët e vegjël, fermerët e rinj, grupet e grave prodhuese, pylltarët etj., dhe ta sjellin këtë zë në proceset e politikëbërjes.

Rrjetëzimi për zhvillimin e qëndrueshëm rural

Rrjetet Kombëtare të Zhvillimit Rural (NRDN) në BP dhe në Kroaci përfaqësojnë një forcë shtytëse në formimin e kontekstit të zhvillimit rural në BP. NRDN-të, të përbëra nga OSHC të përkushtuara, luajnë rolin e katalizatorëve për ndryshim, duke mbrojtur interesat dhe aspiratat e palëve të interesuara rurale. NRDN-të advokojnë për qasje gjithëpërfshirëse, pjesëmarrëse nga poshtë-lart për zhvillimin rural. Ato luajnë një rol të rëndësishëm në nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve të ndryshëm, duke përfshirë autoritetet publike, partnerët ekonomikë dhe socialë dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile.

Krijimi i **Rrjetit Ballkanik të Zhvillimit Rural (BRDN)** forcon më tej ndikimin rajonal dhe shkëmbimin e përvojave. Angazhimi i rrjeteve ndaj zhvillimit të politikave të bazuara në prova dhe i nismave nga poshtë-lart nxit përmirësimin e cilësisë së jetës në zonat rurale dhe përshpejton përafrimin me standardet e Politikës së Përbashkëta Bujqësore (CAP) të BE-së. Kjo qasje proaktive nxit aktorët lokalë, që të angazhohen në mënyrë efektive me qeveritë dhe aktorët e tjerë të rëndësishëm ruralë për të strukturuar politikat dhe veprimet për zhvillimin e qëndrueshëm rural.

Ky produkt financohet nga Bashkimi Evropian. Përmajtja e tij është përgjegjësi vetëm e partnerëve të projektit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian

Email: info@anrd.al | Facebook: Farm to Fork Academy | Instagram: [farmtoforkacademyproject](https://www.instagram.com/farmtoforkacademyproject) |
#FarmToForkWB | #SustainableAgriculture | #GreenInnovation | #Farming4Sustainability |

